

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS PËR SIGURIMIN E PËRGJEGJËSISË CIVILE NDAJ PALËVE TË TRETA ne MJETET UJORE.

1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ligji nr. 10076 datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht Ligji.

Rregullorja e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare miratuar me vendimin nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit” këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht Rregullorja.

Kushtet e Përgjithshme të kontratës për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të motorëve të ujit (JET),skafeve,yachtet,motobarka, për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, këtu më poshtë do të quhen shkurtimisht Kushtet e Sigurimit.

Shoqëria e Sigurimeve SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. këtu më poshtë do të quhet Siguruesi.

Personi fizik ose juridik, përgjegjësia civile e të cilit ndaj palëve të treta mbulohet sipas kontratës, do të quhet shkurtimisht i Siguruari.

2. OBJEKTI I SIGURIMIT

Siguruesi mbulon përgjegjësinë civile të mbajtësit të mjetit ujqor, në përputhje me parashikimet e Ligjit dhe të Rregullores se AMF dhe brenda kufijve të rënë dakord, lidhur me dëmet shëndetësore dhe pasurore të shkaktuara ndaj palëve të treta, për shkak të qarkullimit të mjetit ujqor lundruer të siguruar.

Këtu nuk përfshihen dëmet shëndetësore e pasurore që pësojnë pasagjerët gjatë qarkullimit me keto mjete lundruese si edhe Sendet dhe objektet e përdorimit të zakonshëm, të cilat për vetë natyrën e tyre mbahen më vete nga personat që transportohen, janë objekt i këtij paragrafi.

3. SHTRIRJA TERRITORIALE

Siguruesi mbulon përgjegjësinë ndaj palëve të treta, në kufijtë që përfshihen në koordinatat gjeografike të përcaktuara në certifikatat e mjetit lundruer, lëshuar nga Administrata Detare e Republikës së Shqipërisë ,ne detin Adriatik,detin Jon,liqenet dhe ujqrat e brendeshme te RSH..

4. PËRGJEGJËSIA

4.1 Në varësi të përjashtimeve dhe cilësimeve të deklaruara në këtë dispozitë, Siguruesi do të mbulojë të Siguaruarin, si dhe këdo që ka në kontroll mjetin lundruer me lejen e të Siguaruarit, kundrejt përgjegjësisë civile ndaj palëve të treta si rezultat i pronësisë apo kontrollit të mjetit ujqor, deri në shumën kufi të Përgjegjësisë ndaj Paleve të Treta të deklaruar në policen e sigurimit apo ne Legjislacionin ne fuqi por jo me shume se 50.000,000 lek.

4.2.Siguruesi,brenda shumës së deklaruar më sipër, do të paguajë edhe shpenzimet gjyqësore që bëhen me miratimin e Siguruesit për mbrojtjen ose ndjekjen e çdo

procedure gjyqësore që lind për apo në lidhje me një ngjarje që sjell përgjegjësi që mbulohet nga sigurimi duke përfshirë procedurat përpara gjykatës dhe procedurat për kufirin e përgjegjesisë. Franchiza do të jete 2000 euro dhe nden kete kufi , siguruesi nuk do të jete pergjegjes per deme apo humbje aksidentale.

4.3 Siguruesi do të emerohet të marrë përsipër të drejtoje çdo procedure ligjore që mbulohet sipas pikës 4.2 në emër të çdo personi të mbuluar në sigurim dhe të gjithë këta persona duhet të bashkëpunojnë tërësisht me Siguruesin në ndjekjen dhe/ose mbrojtjen e këtyre proceseve.

4.4 Siguruesi nuk do të paguajë kërkesa për dëmshpërblim që përfshijnë më shumë se një titull në Tabelën e Kompensimeve në lidhje me çdo aksident. Në rastet kur një aksident shkakton paaftësi që pasohet me vdekje që ndodh nga ky shkak brenda 12 muajve kalendarike të ndodhjes së aksidentit, Siguruesi do të paguajë vetëm kompensimin e pagueshëm në rast vdekje.

Siguruesi nuk është përgjegjës sipas këtij neni për:

4.5 Për vdekje apo paaftësi gjate nje aksidenti të personave që ndodhen në bordin e nje mjeti tjetër lundruer si rezultat i një kontrate punësimi, apo për tregëti, profesion apo biznes. Për vdekje apo paaftësi që ndodhin ndërsa mjeti lundruer është përdorur për qëllime të tjera përveç për përdorim privat për kënaqësi.

5. PËRJASHTIME

Siguruesi nuk mbulon përgjegjësinë e mbajtësit të mjetit lundruer në rast se përgjegjësia lind nga:

c) çdo person që ka në kontroll mjetin lundruer për arsye të tjera përveç privatisht për kënaqësi;

d) shkelje të detyrimeve që rrjedhin nga përmbajtja e Certifikatës së Lundrimit, Certifikatës së Sigurimit dhe Lejes së Lundrimit.

Siguruesi nuk mbulon përgjegjësinë ndaj palëve të treta për dëmet që mund të ndodhin për shkak të pjesëmarrjes së mjeteve ujore në gara apo konkurime sportive, si dhe në provat përkatëse ose kur mbajtësi i mjetit lundruer angazhohet në:

- ski ujore
- ski që tërhiqen me motorskaf.
- akuaplan
- parashutë ujore
- apo aktivitete të ngjashme ndërsa ata janë duke u tërhequr nga mjeti lundruer ose duke u përgatitur për tërheqje, as për përgjegjësi që rrjedh nga persona të angazhuar jashtë mjetit ujqor në ndonjë nga këto aktivitete.

Siguruesi nuk do të paguajë kërkesa për dëmshpërblim që rrjedhin nga çdo përgjegjësi e vendosur sipas një kontrate tjetër.

Siguruesi nuk do të paguajë kërkesa për dëmshpërblim për çdo gjobë apo dënim as për çdo përgjegjësi për dëme të shumëfishuara, dëme të dënueshme sipas ligjeve ne fuqi.

Siguruesi nuk do të paguajë kërkesa për dëshmipërblim për përgjegjësi nëse mjete lundruar i deklaruar në Certifikatë, merr pjesë në gara apo teste shpejtësie apo në ngjarje që lidhen me to.

6. PYETËSORI

PyetëSORI që plotëson dhe firmos i Siguruari apo agjenti ose menaxheri përbën bazën e kontratës midis tij dhe Siguruesit. I Siguruari garanton saktësinë e informacionit të deklaruar në pyetëSOR. Nëse ndonjë pjesë e informacionit është e pavërtetë apo e padeklaruar, Siguruesi ka të drejtë të ndërpresë këtë siguracion që prej fillimit të tij apo te mos njohe përgjegjesite e tij ne rast demesh.

7. LUNDRIMI DHE PËRDORIMI

Mjeti lundruar është i mbuluar ndërsa lundron brenda kufijve të deklaruar në Certifikatat e lëshuara nga Administrata Detare, ndërsa është e ankoruar , ndërsa është duke lëvizur brenda dokut, gjatë ripajisjes, ekzaminimit, gjatë berjes së mirëmbajtjes apo survejimit special.

8. PERIUDHA E SIGURIMIT

Ky siguracion fillon ne oren 24.00 te dates qe do te paguhet primi i sigurimit dhe është I vlefshëm për periudhën e treguar në Certifikatë .

9. PËRDORIMI PRIVAT

Mjeti uJOR duhet të përdoret vetëm për përdorim privat dhe në drejtimin e tij duhet të ketë persona kompetentë me miratim të të Siguarit (të pajisur me Të Drejtën e Lundrimit-Patenta detare) dhe nuk do të përdoret me qira apo hua përveç kur kemi rënë dakord që përpara se mjeti do të përdoret për qëllime të tjera dhe Siguruesi ka rënë dakord të paguajë primin shtesë që kërkohet. Nëse bihet dakord, që mjeti mund të përdoret, jepet hua apo me qira, atëherë, mjeti uJOR duhet te Certifikohet per kete aktivitet dhe gjatë gjithë kohës të jetë nën mbikqyrje nga një person i kualifikuar në mënyrë të mjaftueshme dhe duhet që gjatë gjithë kësaj kohe të jetë nën komandën e një personi kompetent.

Mjeti uJOR që do të mbulohet në sigurim, duhet që të lundrojë vetëm midis orëve nga lindja e diellit deri në perëndim sipas orës lokale dhe vetëm për një total prej 50 milje në ditë.

10. TRANSFERIMI I POLICËS

Polica e Sigurimit mund të transferohet sipas kërkesës së të Siguarit në rast se:

a. ndryshon pronësia e mjetit uJOR të siguar. Në këtë rast Siguruesit i lind e drejta e rillogaritjes së primit të sigurimit deri në fund të periudhës së sigurimit duke zbritur kostot e taksave shtetërore dhe shërbimet administrative.

b. mjeti uJOR i siguar pushon së ekzistuari. Në këtë rast polica e sigurimit lëshohet për një mjet tjetër në pronësi të të Siguarit, kundrejt rillogaritjes së primit deri në fund të periudhës së sigurimit.

11. KUJDESI I DUHUR

I Siguruari dhe Menaxherët e tij (nëse ka) duhet që gjithë kohën të ushtrojnë kujdesin e duhur për të mbajtur mjetin uxor lundruar në kushte të sigurta dhe të përshtatshme për lundrim, dhe të parandalojë ndotjen apo rrezikun e ndotjes si pasojë e dëmtimit të mjetit uxor.

12. LIGJSHMËRIA

Është një kusht i këtij sigurimi që i Siguruari dhe çdokush në komandën e mjetit lundruar të jetë në përputhje me Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë, Rregullave Detare lokale dhe çdo ligj që ka lidhje me të dhe të sigurohet që mjeti lundruar të përgjigjet çdo rregullsi sigurie të aplikueshëm dhe fiton çdo leje apo license të kërkuar me ligj.

13. Procedura e Kërkesës për Dëmshpërblim

13.1 Nëse një ngjarje bën të linde një kërkesë për dëmshpërblim sipas çdo Seksioni të këtij siguracioni, i Siguruari duhet të njoftojë sa më shpejt të jetë e arsyeshme (e brenda 24 orësh-Kapitenerine e Portit dhe **SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a.-numri pa pagese 0800 31 31 apo info@sigal.com.al dhe 0692097735/0692055536.**

13.2 I Siguruari duhet të marrë të gjitha hapat e arsyeshme për të ndaluar apo për të minimizuar çdo humbje që do të ishte e dëmshpërblyeshme sipas këtij siguracioni dhe të minimizojë përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

13.3 I siguruari duhet të bashkëpunojë plotësisht me Siguruesin për të siguruar informacionin dhe dëshmitë e duhura dhe duhet të lejojë Siguruesin që të procedojë në emër të tij (por me shpenzimet e Siguruesit) për të fituar dëmshpërblim nga ndonjë palë e tretë në lidhje me mbulimet sipas këtij siguracioni.

13.4 Nëse i Siguruari bën një kërkesë për dëmshpërblim, apo deklaratë që ka lidhje me dëmshpërblimin, për të cilën Siguruesi ka dijeni që është fallco apo mashtruese, apo kur i Siguruari nuk furnizon me informacion në lidhje me një kërkesë për dëmshpërblim, ky siguracion do të bëhet i pavlefshëm që prej fillimit të tij dhe do t'i mbahet i gjithë primi i paguar. Çdo njoftim i Siguruari duhet ta japë te **SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. në adresën zyrtare.**

Kushtet e mbulimit me sigurim, Pyetesori dhe Polica e Sigurimit do të trajtohen nga Siguruesi dhe i Siguruari si një tere.

Firmosja e Polices së Sigurimit nga Siguruesi dhe i Siguruari, presupozon se, palet, i kanë lexuar, kuptuar dhe pranuar të gjitha të drejtat dhe kufizimet që përmban kjo kontratë.

Përveç kur shprehet ndryshe në Certifikatë, ky siguracion do të funksionojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar; ky siguracion është në varësi ekskluzive e juridiksionit të Gjykatës Shqiptare.

Avni PONARI

Drejtore i Përgjithshëm

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sha.